

Министерство за труд
и социјална политикаMinistria e Punës
dhe Politikës SocialeРЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
РЕПУБЛИКА E MAQEDONISË SË VERIUT
Министерство за труд и социјална политика
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

Бр.-Nr.

10-9176/11

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

27-12-2022

год.-viti

MINISTRIA E PUNËS DHE POLITIKËS SOCIALE

СКОПЈЕ - SHKUP

THIRRJE PUBLIKE PËR SIGURIMIN E MJETEVE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE NGA KOMUNAT, QYTETI I
SHKUPIT DHE KOMUNAT NË QYTETIN E SHKUPIT

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale publikon shpallje publike për sigurimin e mjeteve për ofrimin e shërbimeve sociale **NGA KOMUNAT, QYTETI I SHKUPIT DHE KOMUNAT NË QYTETIN E SHKUPIT**, me qëllim të vazhdojë ofrimin e shërbimeve sociale të krijuara në nivel lokal nga ana e komunave, të cilat realizohen në bashkëpunim me ofruesin e licencuar të shërbimit, me mbështetje financiare të ministrisë, për grupet e rrezikuara të qytetarëve, për të cilët është përcaktuar nevoja e llojit të caktuar të shërbimit.

1. Lloji i shërbimeve:

Me Thirrjen publike sigurohen mjete për komunat për sigurimin e:

1. Shërbime në shtëpi;
2. Shërbime në bashkësi;

2. Lartësia e mjeteve që ndahen dhe periudha kohore në të cilën do të jepen shërbimeve sociale

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, do të sigurojë mjete për ofrimin e shërbimeve sociale nga ana e komunave në bashkëpunim me ofruesin e licencuar të shërbimit, sipas çmimit të shërbimit të përcaktuar me Vendimin për përcaktimin e çmimeve të shërbimit të përcaktuar me Vendimin për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve sociale në shtëpi, për mbrojtje brenda-familjes, për ndihmë dhe mbështetje profesionale dhe për qëndrim të përkohshëm për vitin 2023, të miratuar nga ministri i Punës dhe Politikës Sociale nr. 10-8807/1 datë 15.12.2022, të përpiluar në përputhje me Metodologjinë për formimin e çmimeve të shërbimeve në varësi të normave dhe standardeve për ofrimin e shërbimit social (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 264/19). Mjetet do të sigurohen për shfrytëzues të bazës mujore, për të cilën Qendra për Punë Sociale ka lëshuar aktvendim, në periudhë prej lidhjes së Marrëveshjes së bordit me komunën dhe ofruesin e licencuar të shërbimit deri 31.12.2023.

3. Dokumente të nevojshme

Nëse shërbimi social realizohet përmes bashkëpunimit të realizuar të komunës me ofruesin e licencuar të shërbimeve sociale, bashkëngjiten dokumentet në vijim:

1. fletëparaqitje, të nënshkruar dhe verifikuar nga kryetari i Komunës,
2. marrëveshje për bashkëpunim me ofrues të licencuar social (origjinal ose kopje e verifikuar në noter);
3. program për ofrimin e shërbimit social dhe përshkrim të hollësishëm të aktiviteteve me plan konkret të punës për implementimin dhe periudhën e realizimit të programit për ofrimin e shërbimit social për të cilën kërkohen ndarja e mjeteve, emri i plotë dhe adresa e subjektit i cili realizon programin për ofrimin e shërbimit social;
4. Raport Vjetor për punë për vitin e mëparshëm të ofruesit të licencuar të shërbimeve sociale për shërbimin konkretë, gjegjësisht për vitin 2022;
5. vërtetim për tatim të paguar të lëshuar nga organet tatimore të ofruesit të licencuar të shërbimeve sociale jo më të vjetër se gjashtë muaj (origjinal ose kopje të verifikuar në noter);
6. të dhëna të kontaktit për personin përgjegjës/koordinator për realizimin e programit për ofrimin e shërbimit social (emri, mbiemri, e-mail adresa dhe numri i telefonit);
7. listë e personelit profesional dhe personelit tjetër dhe biografia për çdo person që do të angazhohet për ofrimin e shërbimit social;



8. deklaratë e ofruesit të licencuar të shërbimeve sociale të verifikuar në noter se nuk ka fituar mjete nga autoriteti tjetër shtetëror ose njësia e vetëqeverisjes lokale për aktivitetet e njëjta për ofrimin e shërbimit, dhe
9. aktvendim për ofrimin e lejes për kryerjen e punës në kujdesin social (origjinal ose kopje e verifikuar në noter).
10. marveshje e nënshkruar për grant për mirsimin e shërbimeve sociale në kuadër të „ Proektit për përmirsimin e shërbimeve sociale “ (Nr. i marveshjes së huasë #8902-MK)

Ofruesi i licencuar i shërbimeve që ka fituar leje për punë në vitin aktual në të cilën publikohet thirrja publike, nuk i dorëzon dokumentet nga pika 4 dhe 5.

4. Mjete për komunat për ofrimin e shërbimeve sociale do të sigurohen nëse i plotësojnë kushtet në vijim:
 - përvojë e mëparshme në ofrimin e shërbimeve sociale në bashkëpunim me ofruesin e licencuar të shërbimit, Qendra për Punë Sociale dhe/ose Ministria e Punës dhe Politikës Sociale;
 - mekanizëm i krijuar për kontroll të cilësisë së shërbimit dhe sistem i ankesave nga klientët,
 - grupi i qëllimit përkatës të përcaktuar për ofrimin e kujdesit social dhe

Gjatë shpërndarjes së mjeteve, përparësi do të kenë lajmërimi që do të realizojnë përmes bashkëpunimit ndërkomunal, bashkëpunim ndërsektoral dhe bashkëfinancimi i siguar (si dëshmi paraqitet marrëveshja për bashkëpunim).

5. Afatet për zbatimin e procedurës

Thirrja publike zgjatë nga dita e publikimit të ueb faqes së MPPS-së deri më 23.12.2023.

Komunat e interesuara fletëparaqitjet i dorëzojnë përmes arkivit të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, në adresë rr. “Dame Gruev” nr. 14, Shkup, në zarf të mbyllur, me shënim për Thirrje publike për sigurimin e mjeteve për ofrimin e shërbimeve sociale nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit për vitin 2023.

Fletëparaqitjet do të parashtrohen sipas këtij afati dhe me dokumentacion jo të plotë nuk do të shqyrtohen.

Komisioni për sigurimin e mjeteve, në afat brenda 30 ditësh nga dita e parashtimit të fletëparaqitjes, përpilon mendim drejtuar ministrit të Punës dhe Politikës Sociale, pas procedurës së zbatuar në përputhje me Ligjin për mbrojtje sociale dhe Rregulloren për kushtet më të afërta për ofrimin e shërbimeve sociale nga komunat.

Ministri i Punës dhe Politikës Sociale pas marrjes së mendimit nga ana e Komisionit për sigurimin e mjeteve, miraton aktvendim për ndarjen e mjeteve.

Ministri i Punës dhe Politikës Sociale do të lidhë Marrëveshje të bordit me komunën dhe ofruesin e licencuar të shërbimit, me të cilin rregullohen të drejtat reciproke, obligimet dhe përgjegjësitë në realizimin e mjeteve të dhëna, në afat brenda 15 ditësh nga dita e finalizimit të aktvendimit për ndarjen e mjeteve.

Komunat që do të fitojnë mjete nga ana e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, kanë obligim që të gjitha materialet (të shtypura dhe elektronike) që do të prodhohen në kuadër të dorëzimit të shërbimit në vend të dukshëm të qëndron:

Mbështetur nga:

Republika e Maqedonisë së Veriut

MINISTRIA E PUNËS DHE POLITIKËS SOCIALE